

VENDIM
Nr. 154, datë 11.3.2022

PËR NJË SHITESË NË NUMRIN E PUNONJËSVE ORGANIKË NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE, PËR VITIN 2022

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin 2022, shtohet me 42 (dyzet e dy) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 2 459 (dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë) veta.

2. Numri i punonjësve, për vitin 2022, për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit shtohet me 12 (dymbëdhjetë) punonjës dhe për Komitetin e Pakicave Kombëtare shtohet me 4 (katër) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të institucioneve në varësi të Kryeministrit në 1 363 (një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) veta.

3. Numri i punonjësve të Ministrisë së Brendshme, për vitin 2022, shtohet me 2 (dy) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 15 111 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) veta.

4. Numri rezervë i punonjësve, për vitin 2022, reduktohet me 60 (gjashtëdhjetë) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm rezervë në 40 (dyzet) veta.

5. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj